



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:209324
Datë: 22.10.2024
Numri i dokumentit: 06332224

Pml.nr.646/2024

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale ndaj të pandehurit F. R., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 323 par. 4 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPR.nr.682/2024 të datës 20.09.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1DP.nr.1582/2024 të datës 27.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 21.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit F. R., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPR.nr.682/2024 të datës 20.09.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1DP.nr.1582/2024 të datës 27.09.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPR.nr.692/2024 të datës 20.09.2024, të pandehurit F. R., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 323 par. 4 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, e cila masë do t'i llogaritet nga data 21.09.2024 deri me datën 21.11.2024. Masa e paraburgimit i është vazhduar në bazë të nenit 185, nenit 188 lidhur me nenin 184 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PNIDP.nr.1582/2024 e datës 27.09.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësja e të pandehurit F. R. av. Arbnore Pireva Dervisholli, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 184 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP, dispozitës së nenit 185 par. 2 të KPP, dispozitës së nenit 190 të KPP dhe nenit 6 të KEDNJ, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara dhe i pandehuri të lirohet për t'u mbrojtur në liri.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.271/2024 të datës 17.10.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësja e të pandehurit thekson se dispozitivi dhe arsyetimi i aktvendimeve të kundërshtuara është i paqartë dhe në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës, për shkak se i pandehuri në asnjë mënyrë nuk ka interes që të fsheh apo ndryshojë provat e veprës penale, apo të ndikojë në dëshmitarë si dhe se i njëjti nuk ka tentuar në asnjë moment që të ndërmarrë asnjë veprim sa i përket veprës së mashtrimit, para ndodhjes së rastit e as pas rastit, edhe pse ka qëndruar i lirë për rreth një muaj, e që vazhdimisht është paraqitur vullnetarisht në stacionin policor në Kamenicë dhe Prishtinë. I njëjti ka qenë bashkëpunues me policinë, duke qenë korrekt dhe duke treguar të vërtetën, se me kërkesën e F. C., të cilin e ka vendas dhe të njohur prej vitesh, i ka pranuar ato të holla, e për të cilat ka deklaruar edhe në polici se nuk ka qenë në dijeni për veprimet dhe planin mashtrues e të pandehurit tjetër F. C.. Nuk ka as dyshim të bazuar përtej pragut të arsyeshem se i pandehuri të ketë kryer veprën penale për të cilën po hetohet. Vazhdimi i masë më të rëndë të paraburgimit është edhe në kundërshtim me KEDNJ e veçmas me nenin 6 të sajë, i cili parasheh se ndaj personit që ndodhet në paraburgim, organet janë të detyruara që në çdo kohë të vlerësojnë se a ekzistojnë shkaqet dhe arsyet që edhe më tej të zbatohet kjo masë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga kallëzimi penal 2024-AC-494 i datës 24.07.2024, aktvendimit për fillimin e hetimeve, PP/II.nr.3604/24 të datës 25.07.2024, deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit F. B., deklaratat e dëshmitares V. A., raportet e oficerit policorë, procesverbalit të identifikimit e të dyshuarit, transaksionet bankare nga institucionet financiare, komunikimet me mesazhe, deklaratat e të pandehurve, komunikimi përmes rrjeteve sociale, foto dokumentacioni dhe shkresave tjera në lëndë, rezultojnë dyshimi i bazuar se i pandehuri dyshohet se ka kryer veprën penale për të cilën pandehet dhe janë duke u zhvilluar hetimet, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1. e 1.2. të KPP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i ndikimit në dëshmitarë dhe të dëmtuar, apo të bashkë të pandehurit të njëri tjetri që t'i koordinojnë deklaratat dhe fshehjen e provave dhe fakteve me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, ngase ende nuk janë siguruar të gjitha provat dhe duke pasur parasysh që prokuroria gjatë fazës hetimore ka autorizuar policinë për marrjen në pyetje të disa dëshmitarëve si dhe të ndërmarre edhe një sërë veprimesh hetimore, potencialisht mund të ndikojë edhe në dëshmitarët të cilët janë shfaqur në transaksionet bankare e të cilët akoma nuk janë marrë në pyetje nga prokuroria. e në këtë mënyrë do ta pamundëson zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa mbrojtja nga liria, sipas propozimit të mbrojtëses së të pandehurit nuk është masa adekuate për fazën në të cilën ndodhet procedura penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr. 646/2024 me datën 21.10.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi